



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMUNA PORTËZ

Prdt.

Portëz, me 07/10/2014

**KONTRATË**



Procedura e Hapur-Prokurim elektronik

**ME OBJEKT :**

"Ndërtim kopshiti, Komuna Portëz, Fier"

**PALET :**

- ❖ AUTORITETI KONTRAKTOR: KOMUNA PORTËZ, FIER.
- ❖ KONTRAKTUESI: "TILIP" shpk, FIER.





**Objekti i punës: Ndërtim kopshfi, Komuna Portëz, Fier**

Si sipërmarrje Nr.5-6-8-2014 midis Komunes Portëz, Fier, përfaqësuar nga Kryetari z.Azem  
Kopshfi shpk, përfaqësuar në këtë kontratë nga z.Vilson FILIPI të quajtur përkatësisht  
Sipërmarrës dhe Sipërmarrës.

**PERKUFIZIME:**

Do të thotë Kontratë Sipërmarrje Nr.Ref.-5-6-8-2014, me përmbajtje dhe termat në tekstin

“**Kontrates**” është vlefë e plotë në leke përfishi TVSH e fituar në tenderin e datës 02.09.2014.  
Do të thotë “**Ndërtim kopshfi, Komuna Portëz, Fier**”, sipas Projektit të miratuar, Preventivit  
Specifikimeve teknike të dhëna e të pranuar në tender.

“**Investitori**” është Komuna Portëz, Fier, Ministria e Arsimit dhe Sportit (Investitori Qendror).  
(Vendimit Nr.6, datë 10.06.2014 “Për shpërndarjen e fondit për arsimin, fondit i zhvillimit të rajoneve, si  
edhe për një ndryshim në vendimin nr. 5, datë 9.5.2014, të komitetit për zhvillimin e rajoneve, “Për shpalljen  
e thirrjes për ndarjen e fondit për arsimin, fondit për zhvillimin e rajoneve” të Komitetit për Zhvillimin e  
Rajoneve dhe shkresës Nr.5065, prol, datë 25.07.2014 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit).

“**Sipërmarrës**” është “**FILIPi shpk**”, përfaqësuar nga z.Vilson FILIPI.

“**Preventiv**” do të thotë volumet e punës të dhëna në të, shoqëruar me emimet për njësi për secilin ze, të  
cilat nuk mund të ndryshojnë. Volume dhe emimet për secilin ze janë pjesë e Ofertes Fituese.

“**Situacion Pjesor**” do të thotë situacioni për një pjesë të punimeve të preventivit, ku përcaktohen zerat,  
volumet me matje, emimet e fituar në tender, vlefë e tyre, TVSH-ja dhe Vlefë me TVSH.

“**Situacioni Përfundimtar**” do të thotë situacioni për punimet e plota të përcaktuara në preventiv, ku  
përcaktohen zerat, volumet me matje, emimet e fituar në tender, vlefë e tyre, TVSH-ja dhe Vlefë me  
TVSH.

“**Data e kryerjes së plote**” do të thotë data që ndërtimet duhet të mbarohen sic është shprehur në  
grafikun për kryerjen e Ndërtimeve.

“**Kryerja**” do të thotë data e vertetuar se Ndërtimet janë mbaruar.

“**Difekt**” do të thotë çdo pjesë e ndërtimeve e përcaktuar në përputhje me specifikimet teknike të  
kontrates.


“**Data e hyrjes**” do të thotë data që Investitori lejon Sipërmarrësin në Objekt dhe marrjen prej tij në  
dorzim të Sheshit të Ndërtimit me proces-verbal.

“**Materiale**” do të quhen të gjitha furnizimet duke përfshirë edhe ato të konsumueshme, cilësia e të  
cilave vërtetohet me certifikate, të përdorura nga Sipërmarrësi për trupezimin e tyre në ndërtimin e  
objektit.

“**Mbikqyres i punimeve**” (Supervizori) do të thotë subjekt fizik/juridik i licensuar me të cilin  
Investitori ka lidhur Kontratë Mbikqyrje për ndërtimin e Objektit. Detyrat dhe përgjegjësitë e tij janë  
përcaktuara në U.K.M. nr.3 datë 15.02.2001 “Për Mbikqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit”  
(të ndryshuar), U.K.M. Nr.2 datë 13.02.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” (të ndryshuar),  
dhe paraqiten në Kontratën e Mbikqyrjes.

“**Kolaudatori**” do të thotë subjekt fizik/juridik i licensuar me të cilin Investitori ka lidhur Kontratë për  
Kolaudimin e Objektit. Detyrat dhe përgjegjësitë e tij janë përcaktuara në U.K.M. nr. 3 datë 15.02.2001  
“Për Mbikqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit” (të ndryshuar), dhe paraqiten në Kontratën  
e Kolaudimit.

“**Ndërtim**” do të thotë Projekt i Zbatimit dhe Preventivi i Zbatimit, pjesë përberëse e Kontrates.





afateve" do te thote qe, te gjitha afatet per termat e Kontrates llogariten ne dite te kontrates, me perjashtim kur ne Kontrate eshte parashikuar ndryshe. Periudhat dhe limitet kohore do te shprehin te numerohen nga fillimi i dites pas dates se aktit ose veprimit qe sherben per pike nisje per periudhat, ose limitet kohore me perjashtim kur ne Kontrate eshte parashikuar ndryshe. Aty ku nje periudhe ose limit kohore shprehet ne dite, ai do te skadoje ne fund te dites se fundit te periudhes ose limitit kohor. Aty ku dita e fundit e nje periudhe ose limiti kohe bie ne dite feste ne Republiken e Shqiperise, periudha ose limiti kohor do te zgjatet deri ne fund te dites tjeter te punes.

"Afati i Garancise se Punimeve" do te thote periudha prej 24 muaj e cila fillon nga data e aktit te kolaudimit te punimeve, gjate te ciles Sipermarresi riparon me shpenzimet e tij cdo difekt qe ka ardhur si pasojë e cilesise se punimeve te kryer prej tij.

"Garancia e Punimeve", eshte vlera prej 5% e vlefes se situacionit perfundimtare te miratuar.

"Baza ligjore" Kontrata do t'i nenshtrohet, do te qeveriset dhe do te interpretohet sipas ligjeve dhe dispozitave nenligjore ne fuqi te Republikes se Shqiperise, perfshiro te gjitha dokumentat e tenderit dhe te ofertes se Sipermarresit te cilat jane pjese e kesaj kontrate sipas permbajtjes se tyre.

"Force Madhore" do te thote nje ngjarje qe nuk mund te kontrollohet nga palet, ku perfshihen, por nuk jane te limitizuara, lufta, revolucionet, zjarri-permbytja, termeti, epidemite, karantina, embargo tranziti, etj.

## I. OBJEKTI I KONTRATES

"Ndertim kopshti, Komuna Portez, Fier", sipas Projektit, Preventivit te miratuar me zera e volume dhe specifikimeve teknike te pranuar ne tender te cilat jane pjese perberese e kesaj kontrate dhe perbejne detyrim ligjor per zbatim nga palet ne kete kontrate.

## II. VLEFTA DHE AFATI I KONTRATES

Vlefte e fituar ne tender per perfundimin e punimeve ne total eshte:

6.422.150 leke pa TVSH (gjashte milion e katerqind e njezet e dy mije e njeqind e pesedhjetë).

Vlefte totale e Kontrates :

7.706.580 leke me TVSH (shtate million e shtateqind e gjashte mije e peseqind e tetedhjetë).

ne te cilen perfshihet TVSH si dhe te gjitha detyrimet e tjera fiskale ne Republiken e Shqiperise.

Vlera e financuar eshte nga Fondi i Zhvillimit te Rajoneve.


Financimi per vitin 2014 eshte ne vleren 5.500.000 leke.

Diferenca e vleres se plote (pas prokurimit) me vleren e financimit per vitin 2014 do te financohet nga FZHR-ja per vitin 2015.

Afati i kryerjes se punimeve eshte 6 muaj ose 180 dite.

## III. TE DREJTAT DHE DETYRAT E INVESTITORIT

I. Te njohë zyrtarisht Sipemarresin me Mbikqyresin, Kolaudatorin, si dhe t'i dorezoj atij nga nje kopje te Kontrates se Mbikqyrjes dhe Kontrates se Kolaudimit. Nga ana e Komuna Portez, Fier do te



FILIP  
*[Signature]*





...kështu prane sipermarresit, persona te autorizuar prej Kryetarit te cilet do te jene


– Mbikqyesi i punimeve \_\_\_\_\_

– Kolaudatori i punimeve \_\_\_\_\_

2. Te marre te gjitha masat pergatitore per lirimin e Sheshit te Ndertimit dhe te lejoj Sipermarresin te hyj ne Objekt dhe ta dorezoj ate me proces-verbal ne prani te Mbikqyresit.
3. Brenda Dates se Hyrjes te siguroj te gjitha lejet e nevojeshme ligjore ne menyre qe t'i krijoj kushte pune normale Sipermarresit.
4. Te miratoj Situacionin Pjesor dhe Situacionin Perfundimtar te paraqitur e te miratuar nga Mbikqyesi.
5. Ka te drejte qe per te realizuar me se miri anen funksionale te Objektit, te beje ndryshime jo thelbesore ne Projektin e Zbatimit dhe ne Preventivin e Zbatimit, por pa tejkaluar Vleften e Kontrates dhe ne zbatim te U.K.M. Nr.2 date 13.02.2005 "Per zbatimin e punimeve te ndertimit".
6. Te asistoj ne procesin e kolaudimit perfundimtar te Objektit.
7. Te marre ne dorezim Objektin pas kolaudimit perfundimtar.
8. Te veri ne shfrytezim Objektin dhe pas perfundimit te Afatit te Garancise te leshoje Certifikaten e garancise se punimeve.
9. Verifikon kryerjen e riparimit te difekteve te ndodhura dhe per ato qe nuk jane eliminuar llogarit koston e ndreqjes se tyre dhe bene ndalesen nga vlefta e Garancise se Punimeve.

#### IV. TE DREJTAT DHE DETYRAT E SIPERMARRESIT

1. Te siguroj Kontraten ne vleren 10% te vleftes totale te kontrates para lidhjes se saj. Sigurimi i Kontrates te behet ne formen e Garancise Bankare ose Siguracion ne nje nga shoqerite e sigurimeve te licensuara.
2. Te marre ne dorezim Objektin duke reflektuar ne proces-verbalin perkates gjendjen teknike te tij.
3. Me marrjen e Objektit ne dorezim, te filloje menjehere punimet e ndertimit. Data e fillimit te punimeve eshte brenda 5 (pese) diteve nga nenshkrimi i kontrates.
4. Te caktoj drejtuesin/it teknik te tij, te cilet do te drejtojne te gjitha punimet per zbatimin e Projektit te Zbatimit dhe te njoftoj zyrtarisht Mbikqyresin e punimeve dhe Investitorin, duke paraqitur edhe dokumentacionet ligjore te tij/tyre.
5. Te njoh, te respektoj termat e Kontrates te Mbikqyrjes dhe Kontrates se Kolaudimit dhe t'i krijoj kushte normale pune Mbikqyresit dhe Kolaudatorit.
6. Te realizoj Projektin e Zbatimit ne perputhje me Specifikimet Teknike dhe t'i perfundoj punimet ne perputhje me volumet e punes per cdo ze te preventivuar per jo me shume se 1 muaj.
7. Te mos kaloje ne asnje rast vleften e Kontrates te fituar ne tender.
8. Te pranoj cdo ndryshim jo thelbesor te miratuar nga Investitori ne Projektin e Zbatimit dhe ne Preventivin e Zbatimit brenda vleres se Kontrates.
9. Gjate kryerjes se punimeve, te njoftoje ne kohe dhe zyrtarisht Investitorin per ato raste te mosperputhjes se Projektit te Zbatimit dhe te Preventivit te Zbatimit. Deri ne paraqitjen zyrtare te qendrimit te Investitorit per ceshtjet e ngritura, Sipermarresi duhet te nderprese (pezulloje) punimet.
10. Periudha e nderprerjes se punimeve duhet te pasqyrohet ne Proces-Verbalin perkates dhe te vertetohet nga Mbikqyresi i punimeve. Periudha e nderprerjes te punimeve per arsyet e shprehura ne piken 9 te kapitullit IV, merret ne konsiderate per llogaritjen e afatit te perfundimit te punimeve duke shtyre afatin e dorezimit te punimeve per aq kohe sa zgjat nderprerja e punimeve.
11. Te siguroj vete transportin, makinerit, fuqine puntore, drejtimin teknik dhe bazen materiale te nevojshme ne perputhje me specifikimet teknike dhe dokumentat e paraqitur ne tender dhe te paraqese certifikatat e cilesise se tyre. Nuk i lejohet qe rolin e sipermarresit t'ja jape nje subjekti tjetër.






...es tek Investitori per miratim dhe per te realizuar likuidimin e punimeve, Situacion/e te  
...shem/e per punimet e kryera dhe Situacion-Perfundimtar. Situacionet te jene te miratuar edhe  
nga Mbikqyresi i Punimeve.

13. Te njoftoj me shkrim Investitorin per daten e perfundimit te punimeve dhe kerkesen per kolaudimin dhe marrjen ne dorezim te Objektit. Ky njoftim duhet te behet jo me vone se 5 (pese) dite para dates se perfundimit te punimeve.
14. Defektet e konstatuara gjate procesit te kolaudimit dokumentohen dhe nga kolaudatori lihen detyra dhe afate me shkrim per ndreqjen e tyre, keto kosto do te perballohen nga Sipermarresi.
15. Sipermarresi mban pergjegjesi dhe perballon rreziket per demtimin dhe humbjen e materjaleve dhe prones publike e private te te treteve, plagosjen, demtimin apo vdekjen e punonjesve te tij apo personave te trete nga mosrespektimi i rregullave te sigurimit teknik etj. Sipermarresi mban pergjegjesi per zbatimin e akteve ligjore e nenligjore ne fushen e ndertimeve.
16. T'i paraqese Mbikqyresit te Punimeve dhe Kolaudatorit te gjitha dokumentacionin shkresor te perditesuar dhe perfundimtar, si dhe certifikatat e provave te perdorura ne Objekt, te cilet mbas verifikimit dhe pranimit i administrojne ne dosjen e Objektit.

#### V. TE TJERA

1. Menyra e komunikimit midis paleve do te jete vetem me shkrim. Komuna Portez, Fier njeh dhe mban kontakte me perfaqesuesin e "FILIP" shpk, perfaqesuar ne kete kontrate nga z.Vilson FILIPI.
2. z.Vilson FILIPI mban pergjegjesi te plote sipas legjislacionit te prokurimeve publike, shoqerive tregtare dhe atij civil, persa i perket komunikimit, korrespondences dhe dokumentave teknike midis Komunes PORTÉZ dhe "FILIP" shpk.
3. Subjekti "FILIP" shpk merr persiper te gjitha pergjegjesite dhe detyrimet perpara Investitorit Komuna Portez, Fier, si persa i perket cilesise se punimeve, afatit te kryerjes se tyre dhe cdo pergjegjesie tjeter te ligjshme qe do te rrjedhe nga kjo kontrate Sipermarrije, bazuar ne nenin 431 te Kodit Civil te R.SH.
4. Per cdo ceshtje qe lind gjate zhvillimit te punimeve, midis paleve kryhen negociata per zgjidhjen e tyre.
5. Financimi i ketij projekti eshte ne kuader te Vendimit Nr.6, date 10.06.2014 "Per shperndarjen e fondit per arsimin, fondi i zhvillimit te rajoneve, si edhe per nje ndryshim ne vendimin nr. 5, date 9.5.2014, te komitetit per zhvillimin e rajoneve, "Per shpalljen e thirrjes per ndarjen e fondit per arsimin, fondi per zhvillimin e rajoneve" te Komitetit per Zhvillimin e Rajoneve dhe shkreses Nr.5065,prot, date 25.07.2014 te Ministrises se Arsimit dhe Sportit. Financimi per vitin 2014 eshte ne vleren 5.500.000 leke. Diferenca e vleres se plote (pas prokurimit) me vleren e financimit per vitin 2014 do te financohet nga FZHR-ja per vitin 2015.
6. Ne rast nderprerje financimi njihen, meiret ne konsiderate ne llogaritjen e afatit te perfundimit te punimeve, duke shtyre afatin e dorezimit te punimeve.
7. Ne qofte se Sipermarresi braktis Objektin pa e perfunduar ate, duke zgjidhur Kontraten ne menyre te njeanshme, Ai detyrohet te paguaj demin qe i shkakton Investitorit Komuna Portez, Fier, Sipermarresit i njihet volumi i punes se kryer. Por atij do t'i mbahen 20% te vleres se punes se kryer te llogaritur per cdo ze sipas cmimeve te Kontrates dhe Garancia e Kontrates.
8. Palet nuk clirohen nga cdo pergjegjesi per mos zbatimin e termave te kesaje Kontrate, pervec se ne rast te veprimit te foreave madhore te vertetuara nga Institucionet Zyrtare.
9. Sipermarresi, Mbikqyresi i punimeve dhe Kolaudatori jane te detyruar te kontaktojne zyrtarisht me Specialistin e Investimeve prane Drejtorise se Urbanistikes ne Komunen Portez, Fier, pasi ai do te jete personi i kontaktit i cili do te monitoroje gjithe procesin e zbatimit te punimeve, per kete objekt kontrate.





- te punimeve, Sipërmarresi është i detyruar t'i paguaj Investitorit, gjobe do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga sipërmarresit për jo më pak se 25% të vlerës së saj.
- Vepimet financiare per llogari te kesaj Kontrate do te kryhen me sipërmarresit ne Banken \_\_\_\_\_, Dega-Fier ne Nr. e llogarise \_\_\_\_\_ te Sipërmarresit.
- Vepimet financiare per llogari te kesaj Kontrate do te kryhen me sipërmarresit ne Banken \_\_\_\_\_, Dega-Fier ne Nr. e llogarise \_\_\_\_\_ te Sipërmarresit.
12. Cdo mosmarreveshje qe do te linde gjate zbatimit te kesaj Kontrate, palet do ti zgjidhin me mirekuptim, ne te kundert do t'i drejtohen Gjykates se Rrethit Fier.
  13. Pjese perberese e kesaj Kontrate jane edhe Projekti i Zbatimit dhe Preventivi i Zbatimit me cmime qe eshte paraqitur ne tender nga Sipërmarresi si dhe Specifikimet Teknike te punimeve te pranuar dhe Grafiku i Punimeve.
  14. Zhblllokimi i garancise se kontrates 10 per qind te behet pasi te jete perfunduar plotesisht kolaudimi i punimeve, ndersa 5 per qind i garancise se punimeve per periudhen pas kolaudimit zhblllokohet pas perfundimit te garancise se objektit.
  15. Certifikata e Garancise se Punimeve leshohet pas perfunimit te Afatit te Garancise qe eshte 24 muaj, pasi Sipërmarresi, Mbikqyresi, Kolaudatori dhe Investitori kane inspektuar Objektin dhe kane konstatuar qe nuk ka difekte dhe punime te pakryera si dhe qe ai funksionon ne perputhje me Projektin.
  16. Per difektet qe nuk jane ndrequr gjate Afatit te Garancise se punimeve te ndertimit, Investitori llogarit koston e ndreqjes se tyre dhe bene ndalesen nga vlera e Garancise se punimeve qe eshte ne masen 5% te vleres totale te Kontrates.
  17. Cmimet e punimeve do te jene ato te fituara ne tender, sipas preventivit te paraqitur nga Sipërmarresi. Investitori njej ndryshimin e cmimeve ne zbatim te U.K.M. Nr.2 date 13.02.2005 "Per zbatimin e punimeve te ndertimit".
  18. Komuna Portez, Fier mund te beje ne cdo kohe porosi tek Sipërmarresi per te bere ndryshime (specifikime teknike) brenda qellimit te pergjithshem te kontrates.
  19. Sipërmarresi "FILUPI" shpk, eshte i detyruar qe te njoftoje dhe te rakordoje perpara, ne vazhdim dhe ne perfundim te punimeve me OSSHE, OSSH, ALBTELEKOM, UJESJELLES-KANALIZIM per zgjidhjen bashkarisht te problemeve te infrastruktures se tyre, qe te jene prezente me specialistet e tyre kur do te kryhen punime te cilat kane te bejne me proceset teknike-specifike apo me levizjet e materialeve ose objekteve te cilat jane ekskluzivitet i subjekteve te mesiperme. Afati i njoftimit per keto subjekte do te jete 3 (tre) dite perpara kryerjes se punimeve.
  20. Kjo Kontrate hartohet ne 3 kopje, 1 per Sipërmarresin "FILUPI" shpk, perfaqesuar nga z.Vilson FILUPI dhe 2 per Investitorin Komuna Portez, Fier dhe pasi lexohet nga palet, nenshkruhet prej tyre me vullnet te lire ne Portez, sot me date 07/10/2014.

Për dhe në emër të:

**INVESTITORIT**

**KOMUNA PORTEZ**

**Azem SHATERI**



Për dhe në emër të:

**SIPERMARRESI**

**"FILUPI" shpk**

**z.Vilson FILUPI**

**ADMINISTRATORI**

